



**Prishtinë, 14 prill 2011**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_362\_2011**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Duke marrë parasysh:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.6 dhe 2.16, Nenin 25 dhe Nenin 43 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Nr. 03/L-185;
- Rregullën mbi Parimet e Llogaritjes së Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike (Rregulla e Çmimeve);
- Metodologjinë e Tarifave për Sektorin e Energjisë Elektrike; dhe
- Aplikacionin e KEK sh.a. për të Hyra të Lejuara dhe tarifa;
- Aplikacionin e KOSTT sh.a. për të Hyra të Lejuara dhe ngarkesa;

**Në mbledhjen e mbajtur me datë 14 prill 2011 nxori këtë:**

**VENDIM**

**APROVOHEN** tarifat dhe ngarkesat e transmisionit, që do të zbatohen nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT) SH.A. nga data 1 prill 2011.

**Arsyetim**

- I. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datë 28 shkurt 2011 ka pranuar kërkesën për shqyrtimin e tarifave të transmisionit nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT SH.A).
- II. Për vendosjen e tarifave me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet e lëshuara dhe të publikuara në ueb faqen e saj:
  - Shqyrtimi i pestë i tarifave të energjisë elektrike 2011 (SHTE5) – Raporti Konsultativ për KOSTT-in
  - Shqyrtimi i pestë i tarifave të energjisë elektrike 2011 (SHTE5) – Shqyrtimi i komenteve, përgjigjet dhe propozimet e ZRRE-së, lëshuar më 14 prill 2011.
- III. Duke marr parasysh dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të theksuar në hyrje dhe shqyrtimet të të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- IV. Struktura e tarifave dhe ngarkesave për KOSTT SH.A., që do të zbatohen nga data 1 prill 2011 është si në tabelën e mëposhtme:



V.

Grupi Tarifor	Niveli i tensionit të lidhjes	Elementi Tarifor	Njësia	Të miratuara
Gjenerimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.483
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.015
Gjenerimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.483
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.015
Gjenerimi	Distribucioni	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	0.000
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.108
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.015
Furnizimi	400kV / 220kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	3.225
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.483
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.015
Furnizimi	110kV	Ngarkesa për shfrytëzim të sistemit	€/kW/vit	6.650
		Tarifa për Operim të Sistemit	€/MWh	0.483
		Tarifa për Operim të Tregut	€/MWh	0.015

- VI. KOSTT SH.A. duhet ta publikojë këtë vendim në së paku një prej gazetave ditore me qarkullim të gjerë në Kosovë, brenda 5 ditësh të punës pas marrjes së vendimit nga ZRRE dhe publikimit të tij në faqen elektronike të saj.
- VII. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhje në mes të përkthimeve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VIII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Dr. Ali Hamiti, kryesues

\_\_\_\_\_  
Përparim Kabashi, anëtar

\_\_\_\_\_  
Blerim Koci, anëtar

